



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr. 57  
Prishtinë, më 11.3.2019, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Fidan Rekalju, Driton Çausi, Abdyl Salihu, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Albulena Balaj-Halimaj.

**Munguan:** Valentina Bunjaku-Rexhepi, Arbërie Nagavci dhe Verica Çeraniç.

**Përfaqësues të tjerë:** Xhavit Lani, Elhami Hasani, Gani Azemi dhe Nezir Jakupi, mësimdhënës nga kl.1-5, dhe përfaqësues të mediave.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.3.2019;**
- 3. Formimi i grupeve punuese për monitorim të ligjeve;**
- 4. Analizë e gjendjes në Arsim në gjysmëvjetorin e dytë;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.3.2019;**

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 4.3.2019, u miratua pa vërejtje.

### **3. Formimi i grupeve punuese për monitorim të ligjeve**

Ismajl Kurteshi, tha se si Komision jemi pajtuar për formimin e grupeve punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Trashëgimi Kulturor, Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe Ligjit për Inspektoratin e Arsimit. Në njërin nga mbledhjet e kaluara, së bashku me dy nënkryetarët e Komisionit, kemi bërë propozimet për formimin e grupeve punuese dhe kryesuesve të tyre dhe më këtë rast kërkoi që për këto propozime të deklarohen anëtarët e komisionit si dhe të bëhet votimi i tyre. Propozimet e bëra janë si në vijim:

Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturor, ka këtë përbërje: Arbërie Nagavci, kryesuese, Mufera Sinik, Abdyl Salihu dhe Ismajl Kurteshi, anëtarë.

Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, ka këtë përbërje: Luljeta Veselaj-Gutaj, kryesuese, Albulena Balaj-Halimi, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Teuta Haxhiu dhe Ismajl Kurteshi.

Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, ka këtë përbërje: Teuta Haxhiu, kryesuese, Driton Çausi, Fidan Rekalii dhe Ismajl Kurteshi, anëtarë.

Në vazhdim, Kurteshi tha se takimet e grupeve punuese thirren nga kryesuesit dhe anëtarët që janë pjesë e grupit punues dhe janë të obliguar të marrin pjesë në takimet e caktuara. Po ashtu, në këtë takim mund të marrin pjesë edhe anëtarët e tjerë të komisionit, të cilët nuk janë pjesë e grupit punues.

Driton Çausi, në diskutimin e tij tha se në mbledhjen e mëparshme kur është diskutuar për formimin e grupeve punuese, ka propozuar deputeten Arbërie Nagavci si kryesuese të grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, kjo për shkak të përvojës së saj në fushën e arsimit parauniversitar, ndërsa e njëjta nuk është pjesë e këtij grupi punues.

Abdyl Salihu, tha se pajtohet plotësisht me propozimet e bëra për formimin e grupeve të punës.

Luljeta Veselaj-Gutaj, theksoi se pajtohet me propozimet dhe përbërjen e grupeve të punës dhe do të bashkëngjitet edhe grupeve tjera për të dhënë kontributin si anëtare e komisionit. Si kryesuese e grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Arsimin Parauniversitar, do angazhohet maksimalisht për ta nxjerrë një raport me të gjetura reale por edhe me rekomandime konkrete që do të ndihmojnë në ngritjen e cilësisë parauniversitare.

Teuta Haxhiu, propozoi që ftesat për mbajtjen e takimeve të grupeve punuese, t'iu dërgohen edhe anëtarëve tjerë që nuk janë pjesë e atyre grupeve punuese.

Ismajl Kurteshi, kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen me votë për formimin e grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Anëtarët e Komisionit me shumicë votash, miratuan formimin e tre grupeve punuese për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve sipas propozimeve të lartcekura.

Ismajl Kurteshi, i njoftoi anëtarët e Komisionit se GIZ-i ka shprehur gatishmëri që të mbështesë me ekspertizë punën e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Arsimit Parauniversitar.

#### **4. Analizë e gjendjes në Arsim në gjysmëvjetorin e dytë;**

Ismajl Kurteshi, tha se arsyeja e trajtimit të kësaj çështje ka të bëjë me polemikat në mes MASHT-it dhe SBASHK-ut, në lidhje me kompensimin e orëve të humbura nga greva në arsim. Siç jemi të njoftuar, SBASHK-u e ka kontestuar vendimin e ministrit të MASHT-it dhe të njëjtin e ka dërguar në gjykatë. Gjykata e ka refuzuar kërkesën e SBASHK-ut për pezullim të zbatimit të vendimit të MASHT-it. Sipas tij, në momentin që SBASHK-u e ka dërguar rastin në gjykatë, është dashtë që ta respektojë vendimin e gjykatës çfarëdo çoftë ai, sepse nëse në i respektojmë vetëm vendimet që na përshtaten neve, atëherë pse t'i dërgoj në gjykatë. Ai mendon që SBASHK-u duhet ta rishqyrtojë vendimin e saj dhe që të lejohet kompensimi i orëve të humbura të mësimi për aq sa ka mundësi të kompensohet.

Teuta Haxhiu, tha se mbajtja e mësimi për kompensimin e orëve të humbura në disa shkolla gjatë ditëve të shtuna dhe në disa të tjera, është organizim i SBASHK-ut. Marrëveshja e pranuar nga SBASHK-u pas tre javëve për ndërprerjen e grevës ka qenë e propozuar qysh në fillim të organizimit të grevës. Ajo konsideron që sindikata nuk ka qenë aq e vëmendshme me arsimin fillor dhe nuk e ka mbrojtur këtë kategori dhe të cilën është dashtë ta mbrojë. Meqë shumë mësimitdhënës janë për kompensimin e orëve, fton SBASHK-un të dalin më një qëndrim unik lidhur me kompensimin e orëve të humbura. Si Komision në takim me ministrin, jemi pajtuar dhe kemi mbështetur propozimin e tij për kompensimin e orëve të humbura.

Driton Çausi, tha se është e vështirë të bëhet një analizë të mbarëvajtjes së mësimi, pikërisht për shkak të kësaj që po ndodhë. Ai mendon që duhet të këtë një reagim me të përgjegjshëm nga SBASHK-u sepse po flasim për një dëm që është shkaktuar. Dhe ky kundërshtim duke mos e pranuar vendimin e ministrit dhe duke mos dhënë as një zgjidhje për këtë situatë, duket pak e papërgjegjshme nga SBASHK-u. Ai, propozoi që Komisioni të ftojë në takim të përbashkët MASHT-in dhe SBASHK-un, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje.

Luljeta Veselaj-Gutaj, në diskutimin e saj tha se duhet të bëhet një analizë e thellë, jo vetëm për kompensimin e mësimit të humbur, por edhe për situatën e kaosit që është shkaktuar për një kohë të gjatë. Mbarëvajtja e mësimit në disa shkolla tregon qartë ndikimin politik në sistemin arsimor. Sa i përket propozimit të ministrisë për kompensimin e mësimit të humbur gjatë pushimit pranveror, tha se pushimi pranveror është e drejtë ligjore, por njëkohësisht tha se duhet të bëhet një zgjidhje e përbashkët, e mos të dalin në përfundim vetë pa biseduar me sindikatën e arsimit.

Mufera Shinik, ytha se si komision ne jemi pajtuar me vendimin e MASHT-it për kompensim dhe po pajtohem me propozimin e Driton Çaushtit, që ta thërrasim ministrin dhe sindikatën që ta gjejmë një zgjidhje më të thjeshtë.

Abdyl Salihu, tha se pajtohet me propozimin e Driton Çaushtit, që në mbledhjen e radhës të ftohen MASHT-i dhe SBASHK-u për të gjetur një zgjidhje lidhur me kontestin e tyre për kompensim të orëve të humbura dhe mos ti lihet kjo çështje gjykatës.

Ismajl Kurteshi, tha se bazuar në diskutimet dhe propozimet e anëtarëve të Komisionit, propozoi që më se largu deri të premtën të ftohet ministri i MASHT-it dhe përfaqësuesit e SBASHK-ut në mënyrë që të gjendet një zgjidhje për kompensimin e orëve të humbura. Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit.

## **5. Të ndryshme.**

Ismajl Kurteshi, i njoftoj anëtarët e Komisionin me kërkesën e Fondit Kosovaro- Amerikan për Edukim për realizimin e një takimi me Komisionin, për të paraqitur aktivitetet e tyre rreth ndarjes së bursave për studentët tanë. Në vazhdim, ai njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me iniciativën për realizimin e një vizite pune në Luginë të Preshevës.

Teuta Haxhiu, ngriti çështjen e raportit të KKTK-së dhe kontestimin e të gjeturave të tij nga ana e MKRS-së. Haxhiu tha se raporti që kemi marrë nga KKTK-ja, sado që nga ministri dhe kabineti u cilësua si raport koti, atëherë sipas saj dikush duhet të japë përgjegjësi. Të dhënat e raportit dhe ato që janë thënë nga ministria janë krejt të kundërta. Ne jemi dëshmitarë të një mosbashkëpunimi në mes të ministrit dhe KKTK-së, por me e keqja është që buxheti është shpenzuar nga një individ, nga sekretari apo përgjegjës, shefa të atij personeli. Dhe kjo është shumë shqetësuese, prandaj, komisioni duhet të ndërmarrë në lidhje me këtë.

Ismajl Kurteshi, tha se ka qenë propozim i mëhershëm që t'i vizitojmë disa objekte të cilat janë trajtuar dhe që janë në gjendje jo të mirë dhe pastaj të takohemi së bashku me përfaqësues të Ministrisë dhe përfaqësues të Këshillit.

Driton Çausi, nuk kishte konteste mes dy palëve në terren, çështja është kur janë marrë këto vendime, kush ka përgjegjësi dhe nuk e besoj që dalja në terren na sjell ndonjë përfitim rreth situatës, meqë nuk jemi njohës të fushës.

Teuta Haxhiu, tha se një takim i përbashkët me MKRS-në dhe KKTK-në është i mire, nëse nuk mund të marrë pjesë ministri, mjafton të marrin pjesë udhëheqës të departamentit përkatës, po ashtu edhe vizita duhet të bëhen në terren.

Ismajl Kurteshi, propozoi që në mbledhjen e të hënës, të caktohet një takim mes MKRS-së, me theks të veçantë Departamenti për Trashëgimi Kulturorë dhe KKTK-së, të cilët e kanë bërë raportin.

Ismajl Kurteshi, njoftoi anëtarët e Komisionit se pas përfundimit të mbledhjes, Komisioni pret në takim përfaqësues të mësimdhënësve nga klasa e I-V, sipas kërkesës së tyre.

Xhavit Lani, kryesues i grupit të mësimdhënësve nga klasa e I-V, njoftoi anëtarët e Komisionit me peticionin që ua kanë drejtuar të gjitha institucioneve, përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës që ka të bëjë me diskriminimin që u është bërë në raport me mësimdhënësit nga klasat VI-IX me Ligjin për Paga, me rastin e caktimit të koeficienteve.

Ismajl Kurteshi, tha se përgjigje lidhur me diskriminimin që u është bërë mësimdhënësve, duhet kërkuar nga nënshkruesit e marrëveshjes. Lajmin për arritjen e marrëveshjes e kemi marrë përmes mediave, andaj ky grup i mësimdhënësve nuk do duhej të kenë dallime nga mësimdhënësit tjerë, prandaj përgjigjen duhet ta merrni në SBASHK-u, ndërsa sa i përket kërkesave tuaja, ai tha që pajtohet plotësisht, sepse janë të drejta.

Teuta Haxhiu, bëri të ditur që është takuar dy herë me grupe të mësuesve, për të njëjtin problem, dhe pajtohet me kërkesat e grupit të mësuesve. Ajo tha se përgjegjës për këtë diskriminim në koeficient është SBASHK-u. Si zgjidhje të mundshme përmendi mundësinë e shtesave, që ligji i parasheh për disa kategori, andaj duhet analizuar këtë çështje me ekspertë të fushës si dhe mundësinë e inicimit të procedurave për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për paga.

Driton Çausi, tha që gjasat që ne si Komision të bëjmë diçka janë shumë të vogla. E rëndësishme është që kjo bazë e ligjit, pagë e njëjtë për punët të njëjtë është shkelur. Ai tha që tani për tani komisioni nuk ka mundësi të ndryshojë diçka.

Luljeta Veselaj-Gutaj, tha se mbështet kërkesat e mësimdhënësve dhe se përgjegjësia që ju mbani është shumë e madhe, marrim shembull klasën e pestë, ku para disa kohe kanë punuar 12 mësimdhënës, sot janë vetëm dy mësimdhënës. Ajo tha se mbështet kërkesat e grupit të mësimdhënësve.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se Projektligj për paga nuk është shqyrtuar në këtë Komision dhe se propozimi i tillë, po të shqyrtohej nuk do të kalonte. Më tej, ajo tha se edhe ministri Bytyçi ka qenë kundër këtij ligji. Në fakt ka votuar kundër këtij projektligji në Qeveri, dhe marrëveshjen me SBASHK-un nuk e ka bërë ministria, por dihet se nga kush dhe si është bërë ajo marrëveshje. Megjithatë, ajo përkrahu kërkesat e drejta të grupit të mësimdhënësve.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

*E përgatiti:*

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

**Kryetari i Komisionit,**

-----

**Ismajl Kurteshi**